KËRKESË
Nr. 314/9, datë 27.6.2023

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për shpronësimin për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, 'Rikonstruksioni i godinave të spitalit 'Shenjta Mari' dhe Drejtoria e Shëndetit Publik (ish-Spitali Infektiv), Njësia Administrative Rrëshen"'.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Mirditë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vënë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit "truall", bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë" si dhe për pasuritë e llojit "truall", bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", për pasuritë e llojit "ndërtesë", sipas tabelës bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vone se 15 (pesëmbëdhjete) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Mirditë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 890 257 (tetëqind e nëntëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Egra Ibrahimi

LISTA EMERORE E PRONAREVE "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSIONI I GODINAVE TË SPITALIT "SHENJTA MARI" DHE DREJTORIA E SHENDETIT PUBLIK (ISH SPITALI INFEKTIV), NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN".

Nr.	PRONARI			TE DHENAT HIPOTEKORE										"Truall"			"Ndërtesë"		Vlera Totale (Leke)	ADRESA	SHENIME (Kufizime hipotekore,bare mbi pasurine etj.)
	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	Fshati ose Qyteti	Zona Kadastrale	Numri I pasurisë	Lloji I pasurise	Siperfaqja Totale (m2)	"Arë" (m2)	"Truall" (m2)	"Ndërtesë" (m2)	Volumi	Faqe	Siperfaqja (m2)	Çmimi (Lek e m2)	Vlera (Leke)	Siperfaqja (m2)	Vlera e preventivit (Leke)			
	A	B	C	Ç	D	DH	E	Ë	F	G	GJ	H	I	LL	M	N	V	X	XH	Y	Z
1	Mrikë Gjon Përgega ID: G05715040C			Rrëshen	3,224	3//35	Godinë	54	-	54	54	6	127	54	2,351	126,954	54	763,303.0	890,257.00	Rrëshen	s'ka